

Drejtësia civile në Kosovë 2025



Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Blendina Veliqi dhe Florian Smajli

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED) dhe European Endowment for Democracy (EED).

Implementuar nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org
Prill, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	9
2. Barabarësia e trajtimit të rasteve civile	11
3. Numri i lëndëve nga gjykata	13
4. Efikasiteti i gjyqtarëve sipas gjykatave	18
5. Mbajtja e seancave	19
6. Mbajtja e seancave në zyrë	19
7. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile	20
8. Pabarazia e trajtimit të rasteve pronësore	22
9. Ndërmjetësimi	24
10. Shpërndarja e gjyqtarëve	26
11. Rritja e tarifave gjyqësore	28
12. Përfundime	31
13. Rekomandime	33

Metodologjia

Ky raport është bazuar në kombinimin e analizës kuantitative dhe kualitative të praktikës së trajtimit të rasteve civile nga gjykatat në Kosovë gjatë vitit 2025. Për qëllime të këtij hulumtimi, IKD ka analizuar:

- 200 aktgjykime të nxjerra nga gjykatat themelore;
- 100 aktgjykime të nxjerra nga Gjykata e Apelit;
- 77 seanca gjyqësore të monitoruara drejtpërdrejt;
- 50 aktgjykime në rastet pronësore; dhe
- 50 aktgjykime në rastet e pagave jubilarë.

Aktgjykimet janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga vendimet e publikuara në faqen zyrtare në internet të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Natyra e aktgjykimeve të analizuara është si në vijim:

Natyra e rasti	Gjykatat Themelore	Gjykata e Apelit
Raste nga marrëdhënia e punës	110	45
Raste pronësore	15	3
Raste për kompensim dëmi	55	2
Raste të tjera (anulim vendimi, borxhe, familjare, etj.)	20	0
Totali	200	50

Tabela 1. Natyra e rasteve sipas përzgjedhjes të rastësishme.

Ndërkaq, për qëllime të vlerësimit të zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit, janë analizuar edhe procesverbalet e seancave përgatitore të siguruara nga gjykatat përkatëse. Përveç analizës së këtyre dokumenteve, raporti bazohet edhe në të dhëna statistikore të siguruara nga raportet zyrtare të institucioneve të tjera, përfshirë ato të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të dhënat e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës.

Analiza përfshin raste civile të natyrave të ndryshme të trajtuara nga gjykatat gjatë vitit 2025. Në kuadër të kësaj analize janë shqyrtuar barazia e trajtimit të rasteve, ngarkesa e gjykatave, efikasiteti i gjyqtarëve, mbajtja e seancave, mbajtja e seancave në zyrë, kohëzgjatja e trajtimit të rasteve, trajtimi i rasteve pronësore, përdorimi i ndërmjetësimit, shpërndarja e gjyqtarëve, si dhe ndikimi i rritjes së tarifave gjyqësore në qasjen në drejtësi.

Në anën tjetër, pjesë e këtij raporti janë edhe intervistat me kryetarë të gjykatave, të realizuara në kuadër të medias "Betimi për Drejtësi". Veç kësaj, për qëllime të këtij raporti është mbajtur edhe një fokus grup me të gjithë akterët relevant, përfshirë përfaqësues të sistemit gjyqësor, avokatisë dhe shoqërisë civile, si mekanizëm që mundëson diskutimin dhe ballafaqimin me gjetjet kryesore të raportit. Gjithashtu, në funksion të gjithëpërfshirës, ky raport është ndarë për komente me të gjithë akterët relevantë para publikimit të tij.

1. Përmbledhje ekzekutive

Raporti paraqet trendet kryesore të trajtimit të rasteve civile nga gjykatat në Kosovë gjatë vitit 2025. Në fokus të tij janë barazia e trajtimit të rasteve, ngarkesa e gjykatave, efikasiteti i gjyqtarëve, mbajtja e seancave, kohëzgjatja e procedurave, trajtimi i rasteve pronësore, përdorimi i ndërmjetësimit, shpërndarja e gjyqtarëve dhe ndikimi i tarifave gjyqësore në qasjen në drejtësi.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se përderisa disa raste të iniciuara gjatë vitit 2025 janë përfunduar brenda po atij viti, ka raste të cilat kanë marrë epilog vetëm pas më shumë se një (1) deкаде. Një situatë e tillë ngrit dyshime për trajtim të pabarabartë të palëve në rastet civile.

Sa i përket ngarkesës së gjyqësorit me lëndë civile, IKD ka gjetur se të gjitha gjykatat themelore kanë përfunduar pozitivisht, duke ulur numrin e lëndëve të pazgjidhura. Ndërsa, një performancë e tillë nuk është evidentuar në Gjykatën e Apelit, në të cilën është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura. Por, përkundër performancës pozitive, ngarkesa me lëndë civile mbetet e lartë. Veç kësaj, gjetjet tregojnë se ekziston pabarazi në shpërndarjen e gjyqtarëve në raport me ngarkesën me lëndë, ku në disa gjykata, gjyqtarët janë dukshëm më të ngarkuar.

Nga analizimi i efikasitetit të gjyqtarëve sipas gjykatave, gjetjet e IKD-së tregojnë se ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet gjykatave sa i përket numrit mesatar të lëndëve të zgjidhura për gjyqtar. Tutje, gjetjet dëshmojnë se shtyrja e seancave mbetet problematike dhe paraqet regres krahasuar me vitin 2022.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile mbetet e lartë. Rasteve civile u duhen vite për të marrë epilog përfundimtar, ndërsa dallimet ndërmjet gjykatave mbeten të dukshme. Kjo situatë paraqet shqetësim serioz në raport me standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe tregon se zvarritja vazhdon të jetë një nga problemet më të mëdha të drejtësisë civile.

Sipas gjetjeve, del se rastet pronësore zvarriten dukshëm më shumë se kategoritë e tjera të rasteve civile. Kjo situatë ngrit shqetësim serioze në raport me mbrojtjen efektive të së drejtës në pronë dhe me trajtimin e barabartë të qytetarëve sipas natyrës së rasteve të tyre.

Tutje, IKD ka analizuar edhe përdorimin e ndërmjetësimit, si një mekanizëm i fuqishëm për zgjidhjen jashtëgjyqësore të lëndëve. Gjetjet dëshmojnë se

procedura e ndërmjetësimit vazhdon të përdoret në mënyrë shumë të kufizuar. Ndër të tjera, kjo ndodhë edhe për faktin se gjykatat nuk po e zbatojnë në praktikë obligimin për informimin e palëve lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit.

Ndërsa, sa i përket tarifave gjyqësore, në raport specifikohet se është shqetësim serioz për qasjen e qytetarëve në drejtësi. Ndërsa, me këtë shqetësim nuk pajtohet akterët e sistemit gjyqësor.

2. Barabarësia e trajtimit të rasteve civile


Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre gjyqësor, duhet të zbatojnë parimet dhe standardet e trajtimit të barabartë të palëve dhe të shmangin çdo qasje selektive në trajtimin e lëndëve. Ata duhet të respektojnë renditjen kronologjike të trajtimit të rasteve dhe të mos procedojnë rastet e reja para atyre më të vjetra, përveç rasteve kur një prioritet i tillë përcaktohet me ligj ose me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këtë qasje e ka sqaruar edhe Komisioni Këshillëdhënës për Etikën Gjyqësore i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.¹

Megjithatë, hulumtimi i IKD-së tregon se, përderisa ekzistojnë lëndë të deponuara në vitin 2025 të cilat janë përfunduar brenda të njëjtit vit, në gjyqësor vazhdojnë të ketë edhe lëndë që nuk kanë marrë epilog dhe janë të vjetra për më shumë se 12 vite. Vetëm gjatë vitit 2025 janë zgjidhur gjithsej 17 lëndë të iniciuara me padi në po këtë vit. Gjithashtu, janë evidentuar edhe aktgjykime që lidhen me raste të iniciuara në vite shumë më të hershme, përkatësisht në vitin 2013 (1 rast), si dhe në vitet 2015 (1 rast), 2016 (2 raste) dhe 2017 (4 raste).

Numri më i madh i aktgjykimeve, sipas vitit të inicimit të padisë, i përket rasteve të iniciuara në vitin 2024 me gjithsejtë 76 aktgjykime.

Kështu, gjetjet e IKD mbi trajtimin e rasteve civile ngritin dyshime për trajtim të pabarabartë të rasteve civile në gjyqësor. Kjo pasi evidentohen raste që zgjidhen në të njëjtin vit kur deponohen paditë derisa evidentohen edhe raste të cilat zgjidhen pas 12 viteve.

¹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore “*Opinion Këshillëdhënës: për standardet etike të zbatueshme, në rastin e barazisë së palëve, trajtimit të lëndëve gjyqësore sipas prioritetit dhe radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë*”. 13 prill 2024. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/73852_KGJK_Opinioni_KKEGJ_Nr_1_2022.pdf).



Grafiku 1. Shpërndarja e aktgjykimeve sipas vitit të inicimit të padisë (2013-2025).

Të dhënat tregojnë se numri më i madh i aktgjykimeve lidhet me lëndët e iniciuara në vitin 2024 (76 raste), çka sugjeron një fokus të gjykatave në trajtimin e rasteve më të reja. Në të njëjtën kohë, numri i aktgjykimeve për padi të iniciuara në vitet 2013–2017 tregon se disa raste kanë mbetur në procedurë për kohë shumë të gjatë, dhe kjo shpërndarje dëshmon sfida në respektimin e parimit të trajtimit kronologjik të lëndëve dhe në menaxhimin efikas të lëndëve të vjetra në gjyqësor.

Në fokus grupin e organizuar, nga përfaqësues të sistemit gjyqësor u tha se nëse lëndët trajtohen në mënyrë të pabarabartë, atëherë të njëjtën formë trajtohen edhe qytetarët. Megjithatë, u theksua se rezultatet paraqiten në këtë mënyrë për shkak se ka raste të ndryshme që mund të përfundojnë me pohim të kërkesëpadiisë, apo mënyra tjera, e që përfundojnë më shpejtë sesa ato të pranuar më herët.

Se natyra e rasteve mund të ndikojë si faktor në këtë drejtim u përmend gjatë fokus grupit kështu duke përmendur rastet që duhet të trajtohen me prioritet, apo raste tjera për të cilat është vendosur masë, e për të cilat u tha se disa herë mund t’iu jepet prioritet, por jo domosdoshmërisht.

Si raste komplekse u përmendën ato pronësore, për të cilat u theksua se, ndonëse zgjasin me vite, kjo nuk vjen si pasojë e mungesës së vullnetit të gjyqtarëve, por e ndikimit të faktorëve të ndryshëm.

Ndërkaq, u kërkua që lëndët të krahasoheshin sipas natyrës dhe kompleksitetit të tyre si dhe të pasqyroheshin edhe veprimet procedurale të gjykatës, e jo vetëm aktgjykimi. Megjithatë, gjatë draftimit të këtij raporti është konstatuar se ndarja e plotë e ngarkesës sipas këtyre kriterëve është e pamundur, pasi që edhe KGJK nuk i ka të gjeneruara të gjitha të dhënat në mënyrë adekuate, gjë që e bëjnë të vështirë një kategorizim të tillë.

Në anën tjetër, diferenca në mes viteve të lëndëve të përfunduara, nga avokatia u vlerësua si shqetësuese. Mes tjerash u tha se tek palët laike mund të ngritën dyshime të ndryshme kur kupton që disa lëndë të vitit 2024 kanë përfunduar, kurse lëndët e iniciuara nga ata vite më parë, nuk kanë marrë epilog ende.

3. Numri i lëndëve nga gjykata


Sa i përket ngarkesës së gjyqësorit me lëndë, në të tri (3) shkallët e gjykatave, në vitin 2025 gjyqësori e ka nisur me 139,858 lëndë civile, derisa të pazgjidhura në fund të vitit 2025 kanë mbetur 129,641 lëndë. Kështu, gjatë vitit 2025, Gjyqësori ka arritur të zgjidhë 10,219 lëndë më shumë se sa që ka pranuar, për aq sa është ulur numri i lëndëve civile të pazgjidhura në fund të vitit 2025.

Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2025 gjyqësori ka reduktuar numrin e lëndëve të vjetra për 10,219 lëndë, të dhënat tregojnë se sistemi gjyqësor përballet me një numër të konsiderueshëm të lëndëve të trashëguara. Edhe pse një pjesë e gjykatave kanë arritur të zgjidhin një numër të konsiderueshëm të lëndëve gjatë periudhës raportuese, ritmi i zgjidhjes nuk është i mjaftueshëm për të reduktuar ndjeshëm numrin ekzistues të lëndëve të pazgjidhura.

Gjykata Themelore në Prishtinë mbetet institucioni me ngarkesën më të madhe të lëndëve në sistemin gjyqësor. Edhe pse kjo gjykatë ka një numër relativisht të lartë të lëndëve të zgjidhura, stoku i lëndëve të mbetura në procedim mbetet i lartë. Ngarkesa e konsiderueshme vërehet gjithashtu në gjykatat në Prizren dhe Gjakovë. Në anën tjetër, disa gjykata paraqesin raport më të balancuar ndërmjet lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura, duke reflektuar një menaxhim më efikas të fluksit.

Grafiku i mëposhtëm paraqet krahasimin ndërmjet lëndëve të pranuar dhe lëndëve të zgjidhura në gjykatat kryesore të sistemit gjyqësor.

Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura sipas gjykatave



Grafiku 2. Krahasimi i lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura sipas gjykatave.

Sa i përket ndarjes në mes të niveleve të gjykatave, të gjitha gjykatat themelore kanë performuar pozitivisht, pasi kanë zgjidhur më shumë lëndë se sa që kanë pranuar, duke ulur numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Ndërkaq, performancë të fillë nuk ka pasur Gjykata e Apelit, e cila ka zgjidhur 8,384 lëndë më pak se sa që ka pranuar, duke rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Gjykata Supreme ka arritur të zgjidhë 30 lëndë më pak se sa që ka pranuar. Megjithatë, në rastin e Supremes, ngarkesa me lëndë nuk është problematike, për shkak se në fund të periudhës raportuese, të pazgjidhura kanë mbetur vetëm 46 lëndë.

Gjykata	Trashëguara	Pranuara	Në punë	Zgjidhura	Mbetura	Diferenca në mes lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pranuar
Prishtinë	53814	11842	65656	18956	46700	-7114
Mitrovicë	10975	3132	14107	5025	9082	-1893
Pejë	11077	4791	15868	4918	10950	-127
Prizren	15323	3696	19019	7182	11837	-3486
Ferizaj	10065	2959	13024	4489	8.537	-1530
Gjakovë	11,897	3,370	15267	6,201	9,066	-2831
Gjilan	6855	3846	10701	5498	5203	-1652
APEL	19836	22291	42127	13907	28220	+8384
SUPREME	16	120	136	90	46	+30
Total	139858	56047	195905	66266	129641	-10219

Tabela 2. Ngarkesa me lëndë dhe zgjidhja e tyre në raport me ato të pranuar.

Në intervistat e realizuara për "Betimi për Drejtësi" u tha se lëndët civile janë sfida kryesore e ngarkesës me lëndë, kjo pasi përbëjnë numrin më të madh të lëndëve të trashëguara dhe atyre në punë. E kur jemi tek rastet civile, ngarkesë e madhe dalin të jenë rastet e kontratave kolektive.²

² Intervista me Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prizren, Shpresa Emra (Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=BP1Mz2vyNk8> & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e

Mirëpo, gjatë këtyre intervistave pati edhe mendime se nëse kalon Kodi i Procedurës Civile do të ketë ulje të numrit të lëndëve në lëmine civile, për shkak se pritet që të ketë kushte të reja për të ushtruar mjete të jashtëzakonshme në çështjet civile.³

Për më tepër, nga intervistat rezulton se sfida e ngarkesës me lëndë rëndohet edhe më tej nga mungesa e kapaciteteve njerëzore.

Sipas Kryetarit të Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, numri i lëndëve në punë mbetet i lartë dhe ndikon drejtpërdrejt në tejkalinimin e afateve ligjore për trajtimin e rasteve dhe përpilimin e vendimeve, duke theksuar njëkohësisht nevojën për rritjen e stafit administrativ dhe mbështetës.⁴

Në të njëjtën linjë, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Mustaf Tahiri, ka theksuar se përkundër menaxhimit relativisht të mirë të numrit të gjyqtarëve, mungesa e bashkëpunëtorëve profesional mbetet problem serioz. Ai ka shtuar se, në praktikë shpesh ndodhë që dy gjyqtarë të ndajnë një bashkëpunëtor, gjë e cila sipas tij është në kundërshtim me standardin që çdo gjyqtar të ketë mbështetje individuale profesionale.⁵

rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Prizren". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-prizren/>) ; Intervista me Kryetarin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Mustaf Tahiri (Shih linkun: <https://youtu.be/LcJHBrnZiTI?si=Y6a-hsmKMNKbL8LQ>) & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj" (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj/>); Intervista me kryetarin e Gjykatës së Apelit, Valon Totaj (Shih linkun: <https://youtu.be/8G7mvdUHb5g?si=7GLtraCyqjSriMEo>) & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë e Apelit". Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorinë-e-apelit/>; Intervista me Kryetarin e Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepin (Shih linkun: https://youtu.be/J8_HWfE8Pco?si=str_Y88twedpUdMWZ) & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>).

³ "Rexhepi: Nëse miratohet Kodi i Procedurës Civile do të ketë numër më të vogël të lëndëve civile në gjykata". Betimi për Drejtësi. 07 mars 2026, Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rexhepi-nese-miratohet-kodi-i-procedures-civile-do-kete-numer-me-te-vogel-te-lendeve-civile-ne-gjykata/> & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>).

⁴ "Kryetari i Apelit: Gjykata e ngarkuar, rreth 35 mijë lëndë në punë". Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026, Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-apelit-gjykata-e-ngarkuar-rreth-35-mije-lende-ne-pune/> & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë e Apelit". Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorinë-e-apelit/>.

⁵ "Kryetari i Gjykatës në Ferizaj: Jemi mirë me numrin e gjyqtarëve, por jo me atë të bashkëpunëtorëve profesionalë". Betimi për Drejtësi. 15 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-gjyqates-ne-ferizaj-jemi-mire-me-numrin-e-gjyqtareve-por-jo-me-ate-te-bashkepuntereve-profesionale/> & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj" (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-ferizaj/>).

Ngjashëm, edhe në Gjykatën Themelore në Gjiilan, sipas Kryetarit Venhar Salihu, gjykata është vetëm minimalisht e mbuluar me gjyqtarë duke e potencuar si sfidë e cila ndikon në menaxhimin e ngarkesës me lëndë.⁶

Ndërkaq, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Fëllanza Knushaj, ka theksuar se numri i bashkëpunëtorëve profesional nuk përkon me numrin e gjyqtarëve. Ajo ka shtuar se kjo situatë është edhe më e theksuar në divizionin civil, ku për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe kapaciteteve të kufizuara, një pjesë e lëndëve tejkalojnë afatet e arsyeshme për trajtim.⁷

Po ashtu, në nivel të përgjithshëm të sistemit, Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, ka theksuar se mungesa e bashkëpunëtorëve profesional është një problem i përhapur në të gjitha gjykatat, duke qenë se dispozita ligjore që parasheh që çdo gjyqtar të ketë së paku një bashkëpunëtor profesional nuk ka gjetur zbatim për shkak të kufizimeve buxhetore.⁸

Mësime të ngjashme u nxorën edhe nga fokus grupi. Nga përfaqësues të sistemit gjyqësor u tha se për ngarkesën e gjykatave me lëndë nuk është fajtor gjyqësori.

Me theks të veçantë u përmend mos përmbushje e obligimeve nga ana e qeverisë lidhur me kontratat kolektive. Për këtë çështje, u theksua se qeveria do duhej të reflektonte për zbatimin e kontratave kolektive, e jo të vazhdojë të paguaj qindra miliona euro më shumë nga taksat e qytetarëve për shpenzimet e procedurave gjyqësore, si dhe të mos e mbingarkojë sistemin me lëndë. Për më tepër, u kritikua edhe mos ndarja e buxhetit për përmbushjen e nevojave të sistemit gjyqësor.

⁶ “Salihu tregon sfidat me të cilat përballet Gjykata Themelore në Gjiilan”. Betimi për Drejtësi. 2 prill 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/salihu-tregon-sfidat-me-te-cilat-perballet-gjykata-themelore-ne-gjilan/> & “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjiilan”. Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjilan/>.

⁷ Intervistë e realizuar me Fëllanza Knushaj, Kryetare e Gjykatës Themelore në Gjakovë me 23 mars 2026 & IKD. “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjakovë”. Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjakove/>.

⁸ “Arsyetimi i vendimeve, Kryetari Supremes thotë se e kanë trajtuar në vazhdimësi këtë çështje, flet edhe për rritjen e taksave gjyqësore”. Betimi për Drejtësi. 7 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-vendimeve-kryetari-supremes-thote-se-e-kanë-trajtuar-ne-vazhdimësi-këtë-çështje-flet-edhe-per-rritjen-e-taksave-gjyqësore/> & IKD. “Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme”. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>).

4. Efikasiteti i gjyqtarëve sipas gjykatave

Sipas Rregullores Nr. 13/2025 për Normën e Punës së Gjyqtarëve, norma e punës për gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil përcaktohet me sistem pikësh, varësisht nga kategoria e lëndës. Konkretisht, lëndët që janë në kompetencë të këtij divizioni vlerësohen me 6.5 pikë, lëndët civile që përfundojnë me marrëveshje ndërmjetësimi me 3.5 pikë, ndërsa lëndët për pagat jubilarë, përcjelljen në pension, shpërblimet e fundvitit (pagat e 13-ta), çështjet përmbartimore, masat e sigurimit të kërkesave, si dhe lëndët që përfundojnë me vendim procedural ose me ndërprerje të procedurës, vlerësohen me 2 pikë. Po ashtu, lëndët nga procedura jokontestimore vlerësohen me 4.5 pikë, ndërsa kontestet pronësore dhe çështjet tjera më komplekse, si vërtetimi i pronësisë, servitutet, parablerja, barra sendore, e drejta e ndërtimit, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit, pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, si dhe kontestet për fyerje e shpifje dhe kontestet me padi e kundërpadi me shqyrtim kryesor, vlerësohen me 12 pikë.

IKD ka analizuar edhe efikasitetin e gjyqtarëve në trajtimin e lëndëve civile, duke krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura me numrin e gjyqtarëve të angazhuar në secilën gjykatë. Gjetjet tregojnë se në vitin 2025, në nivel të të gjitha gjykatave themelore janë zgjidhur gjithsej 52,269 lëndë civile, nga 128 gjyqtarë të angazhuar. Kjo rezulton me një mesatare prej 405 lëndësh të zgjidhura nga një gjyqtar gjatë vitit raportues.

Megjithatë, analiza sipas gjykatave individuale tregon dallime të dukshme në mes të tyre. Efikasiteti më i lartë është evidentuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në të cilën një gjyqtar mesatarisht ka zgjidhur 564 lëndë, pasuar nga Prishtina me 451 lëndë, Prizreni me 449 lëndë dhe Gjilani me 423 lëndë për gjyqtar. Në anën tjetër, efikasitet më i ulët është evidentuar në Ferizaj me 345 lëndë, Mitrovicë me 314 lëndë dhe Pejë me 289 lëndë të zgjidhura për gjyqtar. Këto të dhëna tregojnë se ekzistojnë dallime të konsiderueshme në performancën mesatare të gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura. Megjithatë, deri në një masë, duhet theksuar se ky rezultat potencialisht mund të jetë i ndikuar edhe nga lloji i lëndëve të zgjidhurave.

Gjykata	Lëndë të zgjidhura	Numri i gjyqtarëve të angazhuar	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga një gjyqtar
Gjakovë	6201	11	564
Prishtinë	18956	42	451
Prizren	7182	16	449
Gjilan	5498	13	423
Ferizaj	4489	13	345
Mitrovicë	5025	16 ⁹	314
Pejë	4918	17	289
Total	52269	128	405

Tabela 3. Efikasiteti i gjyqtarëve.

5. Mbajtja e seancave

Nga gjithsej 77 seanca gjyqësore të caktuara dhe të monitoruara, IKD gjen se 60 prej tyre janë mbajtur, ndërsa 17 seanca janë shtyrë për arsye të ndryshme. Shprehur në përqindje, rezulton se 22% e seancave gjyqësore në rastet civile janë shtyrë. Kjo tregon një nivel relativisht të lartë të shtyrjes së seancave në proceset civile.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2022, kur përqindja e seancave të shtyra ishte 18.5%,¹⁰ rezulton se në vitin 2025 ka regres në këtë aspekt, pasi është shënuar rritje e përqindjes së seancave të shtyra. Një situatë e tillë ndikon drejtpërdrejt në zvarritjen e procedurave gjyqësore dhe në kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve civile.

6. Mbajtja e seancave në zyrë

Nga monitorimi i drejtpërdrejtë i IKD-së, njëra ndër problematikat e evidentuara në seancat e rasteve civile ka të bëjë me mbajtjen e seancave gjyqësore në zyrat

⁹ **Shënim:** Raporti vjetor statistikor nuk përmban të dhëna në lidhje me degën e Leposaviq dhe Zubin Potok. Sipas zyrës për informim, numri i gjyqtarëve të angazhuar ka qenë 16.

¹⁰ Mërlaku A., dhe Bllaca N. "Drejtësia Civile 2022". Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 5. Prishtinë. Gusht 2023. (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-final-Drejtësia-civile_2022-final.pdf).

e gjyqtarëve dhe jo në sallat e gjykimeve¹¹. Fillimisht, duhet theksuar se në disa raste kjo mund të lidhet me mungesën e sallave të mjaftueshme për zhvillimin e seancave. Megjithatë, gjatë monitorimit në terren është vërejtur se kjo praktikë ndodh edhe në situata kur ka salla të lira në dispozicion, por gjyqtarët zgjedhin që seancat gjyqësore t'i zhvillojnë në zyrat e tyre.

Nga ajo që është evidentuar gjatë monitorimit, një praktikë e tillë krijon një pamje jo adekuate të funksionimit të gjykatave, pasi zhvillimi i seancave gjyqësore në zyrë nuk reflekton standardin institucional që duhet të ketë një proces gjyqësor. Për më tepër, mbajtja e seancave në zyrë shpesh krijon vështirësi praktike në administrimin e seancës, për shkak të hapësirës së kufizuar dhe organizimit jo të përshtatshëm për zhvillimin e procedurave gjyqësore.

Veç kësaj, një praktikë e tillë ndikon edhe në qasjen e monitoruesve dhe publikut në seancat gjyqësore, pasi hapësirat e zyrave zakonisht nuk ofrojnë mundësi për pjesëmarrje të publikut apo të palëve të interesuara në të njëjtën mënyrë si sallat e gjykimeve.

Në fokus grup, lidhur me mbajtjen e seancave në zyra, me theks në Gjykatën Themelore në Prishtinë, u tha se numri i sallave gjyqësore është i vogël dhe se pjesën më të madhe të kohës janë të rezervuara për raste tjera. Në këtë drejtim, u tha se do duhej të kërkohej shtimi i sallave për mbajtjen e seancave gjyqësore, derisa u theksua se mbajtja e seancave në salla do ndikonte për mirë në punën e gjykatës.

7. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile

Bazuar në aktgjykimet a analizuara për qëllime të këtij raporti, rezulton se mesatarja e kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve civile në gjykatat themelore është rreth 875 ditë. Megjithatë, dallime të dukshme vërehen ndërmjet gjykatave. Kohëzgjatja më e lartë është evidentuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e pasuar nga ajo në Mitrovicë. Ndërsa, kohëzgjatja më e ulët për trajtimin e rasteve është evidentuar në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe atë në Ferizaj. Këto të dhëna tregojnë se kohëzgjatja e trajtimit të rasteve, veçanërisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe atë në Mitrovicë vazhdon të mbetet tejet e lartë. Ndërkaq, dallimet tregojnë se trajtimi i rasteve civile nuk është i njëtrajtshëm në të

¹¹ "Sfidat e mbajtjes së seancave në zyra të gjykatësve". Betimi për Drejtësi. 2 janar 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/sfidat-e-mbajtjes-se-seancave-ne-zyra-te-gjykatavesve/>)

gjitha gjykatat, duke reflektuar edhe nivele të ndryshme të efikasitetit në trajtimin e tyre.

Gjykata	Aktgjykime të analizuara	Koha mesatare e zgjidhjes
Prishtinë	30	1174.46
Mitrovicë	28	1032.57
Pejë	28	909.61
Prizren	28	904.29
Gjakovë	28	745.14
Ferizaj	28	702.39
Gjilan	30	651.63
Total	200	875.1

Tabela 4. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve sipas gjykatave themelore.

Përmes 100 aktgjykimeve, IKD ka analizuar edhe kohëzgjatjen e trajtimit të rasteve në Gjykatën e Apelit. Kjo është bërë duke matur kohëzgjatjen mesatare nga momenti i nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë deri në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit nga Gjykata e Apelit. Gjetjet e IKD-së tregojnë se kjo kohëzgjatje mesatare është 611 ditë.

Kështu, nëse merret parasysh kohëzgjatja mesatare e trajtimit të rasteve në gjykatat themelore dhe ajo në Gjykatën e Apelit, rezulton se një rast civil, nga momenti i inicimit të tij deri në momentin kur merr formë të prerë, zgjat mesatarisht rreth 1451 ditë.

Një kohëzgjatje e tillë konsiderohet e lartë dhe paraqet shqetësim serioz në raport me standardin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga gjyqësori vlerësojnë se lëndët në divizionin civil zgjasin më shumë për shkak të mbingarkesës dhe prioritizimit të lëndëve.¹²

Gjithashtu, edhe në fokus grup u theksua çështja e prioritizimit. Ndërkaq u fol edhe rreth kompleksitetit të lëndëve, me theks ato pronësore, ku u theksuan faktorë të ndryshëm që ndikojnë në kohëzgjatjen e zgjidhjes së rasteve, sikurse pamundësia e marrjes së historikut para vitit 1999, pastaj prezenca e palëve në procedurë përderisa në shumë raste të vjetra ka palë të komunitetit serb, marrja në pyetje e shumë dëshmitarëve, nevoja për të caktuar numër të madh të seancave, ndërprerja e procedurave deri në sigurimin e provave etj. Si shembull u morr edhe çështja e rigjykimit, ku u tha se ka raste për të cilat ka disa vendime gjyqësore dhe se është kthyer disa herë në rigjykim, duke theksuar se nënkuptohet që ka pasur veprime nga ana e gjykatës vazhdimisht. Tek rigjykimi u theksua edhe se nëse një gjyqtarit i kthehen një numër i lartë i rasteve në rigjykim, atëherë i pamundësohet caktimi i atyre rasteve brenda afatit prej 30 ditësh. Megjithatë, u pranua se ka ende vend për përmirësim.

8. Pabarazia e trajtimit të rasteve pronësore

Pronësia paraqet njërin ndër institutet kryesore civile-juridike në çdo rend juridik. Në Kosovë, pronësia garantohet përmes Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjit. E drejta e pronësisë më tutje rregullohet në mënyrë më të detajuar me Ligjin Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Sa i përket trajtimit të rasteve pronësore, IKD ka gjetur probleme të theksuara në administrimin e këtyre rasteve, në veçanti sa i përket kohëzgjatjes së trajtimit të tyre. Në këtë drejtim, IKD gjen se kohëzgjatja në trajtimin e rasteve të tilla, paraqet zvarritje të veçantë përtej zvarritjes së përgjithshme që karakterizon procedurat civile. Për qëllime të këtij raporti janë analizuar gjithsej 50 aktgjykime në rastet pronësore dhe 50 aktgjykime në rastet e pagave jubilarë, nëpër Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës.

Bazuar në aktgjykimet e analizuara, rezulton se rastet pronësore zvarriten dukshëm më shumë se sa rastet e natyrave të tjera. Krahasuar me rastet e pagave jubilarë, del se mesatarja e trajtimit të rasteve pronësore është rreth 1720 ditë, ndërsa në rastet e pagave jubilarë kjo mesatare është 794 ditë. Kjo

¹² Intervista me Fëllanza Knushaj (Kryetare e Gjykatës Themelore në Gjakovë) & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Themelore në Gjakovë". Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-themelore-ne-gjakove/>.

nënkupton se rastet pronësore zgjasin më shumë se dyfishin e kohës së nevojshme për trajtimin e rasteve të pagave jubilarë.

Këto të dhëna tregojnë se në praktikë rastet pronësore trajtohen me një ritëm dukshëm më të ngadalshëm krahasuar me disa kategori të tjera të kontesteve civile. Një situatë e tillë ngrit shqetësime serioze në raport me mbrojtjen efektive të së drejtës në pronë, pasi zvarritja e gjatë e procedurave gjyqësore ndikon drejtpërdrejt në sigurinë juridike të qytetarëve dhe në realizimin praktik të kësaj të drejte themelore. Për më tepër, kjo situatë ngrit dyshime për trajtim të pabarabartë të qytetarëve, duke u bazuar në natyrën e rasteve të iniciuara.

Gjykata	Aktgjykime të analizuara në rastet pronësore	Koha mesatare e zgjidhjes së lëndëve pronësore	Aktgjykime të analizuara në rastet e pagave jubilarë	Koha mesatare e zgjidhjes së lëndëve të pagave jubilarë
Prishtinë	12	2848.08	15	1275
Mitrovicë	9	1750.33	10	1078.90
Pejë	6	1345.67	5	820.40
Prizren	6	2484.67	4	702.50
Ferizaj	5	1691	5	560.80
Gjakovë	6	1153	6	869.83
Gjilan	6	771.50	5	254.60
Total	50	1720.61	50	794.58

Tabela 5. Kohëzgjatja e lëndëve pronësore.

Sa i përket krahasimit ndërmjet rasteve pronësore dhe rasteve të pagave jubilarë, përfaqësuesit e gjyqësorit në fokus grup theksuan se, në kuadër të strategjisë së

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është synuar që rastet e pagave jubilarë në shumicën e rasteve të përfundojnë jashtë seancës gjyqësore, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe ofrimin sa më të shpejtë të drejtësisë për qytetarët.

Ndërkaq, u sqarua se rastet pronësore janë më komplekse, pasi përfshijnë prova dhe propozime të ndryshme, seancat mund të shtyhen me kërkesë të përbashkët të palëve, si dhe lëndët mund të kthehen në rigjykim për shkak të mosshqyrtimit të ndonjë prove që rezulton e domosdoshme. Për këtë arsye, u tha se gjyqtarët tregojnë kujdes më të madh gjatë vendosjes në rastet pronësore sesa në lëndë të tjera.

Po ashtu, si shkak i dallimit në kohëzgjatje, u përmend edhe fakti se lëndët pronësore zakonisht nuk trajtohen me prioritet, ndryshe nga disa raste të natyrave të tjera.

Kurse, prej çështjeve më problematike, sipas përfaqësuesve të sistemit gjyqësor u përmend se në shumë raste janë të përfshira palë të komunitetit serb dhe vështirësitë për të siguruar prezencën e tyre, si dhe pamundësia për siguruar historiatin e pronës për kohën para vitit 1999, e për të cilën u tha se është problematikë shtetërore.

9. Ndërmjetësimi

Njëra prej metodave më efektive dhe jo formale për zgjidhjen e lëndëve është procedurave e ndërmjetësimit. Në secilën fazë, palët mund të tentojnë që rastin e tyre ta zgjidhin përmes procedurës së ndërmjetësimit. Nëse arrijnë zgjidhje të kontestit të tyre përmes procedurës së ndërmjetësimit, vendimi i përpiluar tek ndërmjetësuesi është ekuivalent me vendimin gjyqësor, pa marrë parasysh mënyrën e referimit të rastit në ndërmjetësim¹³. Kjo formë e zgjidhjes së mos marrëveshjeve u mundëson palëve që në mënyrë të shpejtë dhe pa formalizime procedurale të zgjidhin rastet e tyre.

Sipas statistikave nga Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës, gjatë viti 2025 janë zgjidhur vetëm 1970 lëndë nëpërmjet procedurës së ndërmjetësimit në të gjitha gjykatat themelore në Kosovë, ndërkohë që në të gjitha gjykatat janë zgjidhur gjithsej 52 mijë 269 lëndë. Shprehur në përqindje, rezulton se vetëm 3.76% e

¹³ Ligji nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, neni 3.1.1.6.

lëndëve të zgjidhura janë zgjidhur në procedurë të ndërmjetësimit. Në rastin e Prokurorit të Shtetit, numri i lëndëve të zgjidhura në procedurë të ndërmjetësimit është 2635, ndërsa me vetëinicimin e palëve, janë zgjidhur 7332 lëndë¹⁴.

Me qëllim të rritjes së aplikimit të procedurës së ndërmjetësimit, KGJK ka miratuar Rregulloren Nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave. Kjo rregullore ka përcaktuar se “Edhe gjyqtari në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kanë mundësi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit¹⁵”.

Me qëllim të vlerësimit nëse gjykatat kanë zbatuar obligimin për informimin e palëve lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit, IKD ka kërkuar nga gjykatat qasje në procesverbalet e seancave përgatitore. Nga analiza e procesverbaleve të pranuar rezultoi se, në asnjë prej rasteve të analizuara, gjyqtarët, sipas përmbajtjes së procesverbaleve, nuk i kanë njoftuar palët për këtë mundësi, në përputhje me obligimin që rrjedh nga Rregullorja për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave.

Kjo situatë tregon se obligimi për promovimin e ndërmjetësimit në fazat e hershme të procedurave gjyqësore civile nuk po zbatohet në praktikë, sipas obligimit që Gjyqtarët kanë. Mosinformimi i palëve për mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit kufizon përdorimin e këtij mekanizmi dhe ndikon që një numër i madh i rasteve të vazhdojnë trajtimin përmes procedurave të rregullta gjyqësore, përkundër se ato mund të zgjidhen nëpërmjet procedurës së ndërmjetësimit. Si rrjedhojë, mos përmbushja e këtij obligimi nga ana e gjyqtarëve është po ashtu faktor i mos shfrytëzimit të mjaftueshëm të procedurës së ndërmjetësimit nga qytetarët.

¹⁴"*Statistikat mbi Zgjidhjen e Lëndëve me Ndërmjetësim gjatë vitit 2025*". Oda e Ndërmjetësuesve. (Shih linkun: <https://ndermjetesimi.com/Statistikat-mbi-Zg/>)

¹⁵ Rregullore Nr.04/2019 për Procedurën e Ndërmjetësimit të Lëndëve të Gjykatave, neni 4.

Gjykata	Numri i procesverbaleve të analizuara	Numri i referimeve për ndërmjetësim
Prishtinë	7	0
Mitrovicë	10	0
Pejë	9	0
Prizren	Pa përgjigje	/
Ferizaj	10	0
Gjakovë	10	0
Gjilan	10	0

Tabela 6. Referimi në ndërmjetësim në seancat përgatitore.

Në fokus grup, përfaqësuesit e sistemit gjyqësor theksuan se kjo çështja e ndërmjetësimit ka mbetur pas dhe nuk është zhvilluar në nivelin e duhur. Ata shtuan, se kjo procedurë duhet të avancohet dhe të forcohet më tej nga sistemi gjyqësor, pasi do të kishte ndikim të rëndësishëm në uljen e ngarkesës së gjyqësorit me lëndë.

10. Shpërndarja e gjyqtarëve

Shpërndarja proporcionale e gjyqtarëve, në përputhje me ngarkesën me lëndë, paraqet një element të rëndësishëm të administrimit të mirë të sistemit të drejtësisë. Sa i përket kësaj shpërndarjeje, IKD gjen se gjatë vitit 2025 ekzistojnë dallime të konsiderueshme në mes të gjykatave lidhur me ngarkesën mesatare të gjyqtarëve civilistë. Nga të dhënat e analizuara rezulton se një gjyqtar civilist në Gjykatën Themelore në Prishtinë është i ngarkuar mesatarisht me 1,563 lëndë, derisa mesatarisht një gjyqtar në Pejë është i ngarkuar me 933 lëndë, ndërsa në Gjilan me 823 lëndë.

Këto të dhëna tregojnë se ekziston një mosbarazi në shpërndarjen e gjyqtarëve në raport me ngarkesën me lëndë, pasi në disa gjykata gjyqtarët përballen me një numër dukshëm më të madh të rasteve në punë krahasuar me gjykatat e

tjera. Një situatë e tillë mund të ndikojë në efikasitetin e trajtimit të rasteve dhe në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, pasi gjyqtarët në gjykatat më të ngarkuara përballen me një volum dukshëm më të madh të punës.

Në këtë kontekst, IKD vlerëson se një prej mënyrave për të stabilizuar këtë situatë është që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të shqyrtojë mundësinë e rishpërndarjes së gjyqtarëve përmes institutit të transferimit, në mënyrë që gjyqtarët të angazhohen në gjykatat ku ngarkesa me lëndë është më e lartë. Një qasje e tillë do të mund të kontribuonte në balancimin e ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave, duke ndikuar në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë civile dhe në uljen e kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve.

Gjykata	Në punë	Numri i gjyqtarëve civilist	Mesatarja e lëndëve për një gjyqtar
Prishtinë	65656	42	1563
Mitrovicë	14107	14 ¹⁶	1007
Pejë	15868	17	933
Prizren	19019	16	1188
Ferizaj	13024	13	1001
Gjakovë	15267	11	1387
Gjilan	10701	13	823

Tabela 7. Mesatarja e lëndëve për një gjyqtar.

¹⁶ **Shënim:** Raporti vjetor statistikor nuk përmban të dhëna në lidhje me degën e Leposaviq dhe Zubin Potok. Sipas zyrës për informim, numri i gjyqtarëve të angazhuar ka qenë 16.

11. Rritja e tarifave gjyqësore

Me 1 janar 2026 ka hyrë në fuqi Udhëzimi i ri Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i cili ka rritur ndjeshëm taksat gjyqësore në disa kategori duke përfshirë edhe rastet civile.

Sa i përket padive civile të qytetarëve, të dhënat tregojnë se tarifat gjyqësore janë rritur ndjeshëm në pothuajse të gjitha kategoritë e vlerës së kontestit. Për paditë me vlerë deri në 1,000 euro, tarifa gjyqësore është rritur nga 20 euro në 60 euro, që paraqet një rritje prej 200 për qind. Në mënyrë të ngjashme, për paditë me vlerë nga 1,001 deri në 2,500 euro tarifa është rritur nga 30 euro në 60 euro, që përfaqëson një rritje prej 100 për qind. Ndërkaq, për paditë me vlerë nga 2,501 deri në 5,000 euro tarifa është rritur nga 40 euro në 60 euro, ose rreth 50 për qind më shumë se niveli i mëparshëm.

Rritje edhe më e theksuar evidentohet në rastet me vlerë më të lartë të kontestit. Për paditë me vlerë nga 5,001 deri në 10,000 euro, tarifa gjyqësore është rritur nga 60 euro në 150 euro, që përfaqëson një rritje prej 150 për qind. Në kategoritë e kontesteve me vlerë më të lartë janë vendosur gjithashtu tarifa fikse më të larta krahasuar me sistemin e mëparshëm, duke rritur në përgjithësi barrën financiare për palët që iniciojnë procedura gjyqësore.

Rritje të tarifave janë evidentuar edhe në disa kategori të tjera të çështjeve civile që lidhen me të drejtat pronësore apo të drejtat tjera sendore. Për shembull, në rastet e pengimit të posedimit, servituteve dhe vërtetimit të pronësisë, tarifa gjyqësore është dyfishuar, duke u rritur nga 50 euro në 100 euro. Ndërkohë, në rastet e divorcit dhe alimentacionit tarifa është rritur nga 50 euro në 60 euro, që paraqet një rritje prej rreth 20 për qind.

Në këtë kontekst, rritja e ndjeshme e taksave gjyqësore paraqet shqetësim serioz në raport me qasjen e qytetarëve në drejtësi. Përkundër faktit se vendosja e taksave gjyqësore është legjitime, ato duhet të jenë proporcionale dhe të balancuara, në mënyrë që të mos krijojnë barriera financiare për qytetarët që kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre përmes gjykatave. Rritja e konsiderueshme e tarifave, veçanërisht në disa kategori të kontesteve civile, rrezikon që për një pjesë të qytetarëve iniciimi i procedurave gjyqësore të bëhet më i vështirë nga aspekti financiar.

Në anën tjetër, gjatë intervistave të realizuara në “Betimi për Drejtësi”, nga kryetarë të gjykatave u mohua që kjo rritje e taksave ua kufizon qytetarëve qasjen në drejtësi.¹⁷

Kryetari i Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, theksoi se në secilin vend të rajonit, taksat gjyqësore janë më të larta. Ai tha se ka kaluar vetëm një kohë e shkurtër që prej kur ka filluar të zbatohen, duke shtuar se vlerëson që KGJK është fleksibil në këtë drejtim dhe varësisht prej situatave që do të krijohen, eventualisht ndoshta mund ta rishikojë këtë udhëzim.¹⁸

Se nuk ka asgjë të keqe për rritjen e taksave gjyqësore, tha edhe kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi. Sipas tij, taksat kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta dhe se nuk është ndonjë shqetësim për faktin se qytetarët që nuk kanë mundësi të paguajnë, të lirohen prej taksave.¹⁹

Edhe në fokus grup, përfaqësues të gjyqësorit thanë se rritja e taksës gjyqësore nuk ia cenon qytetarëve qasjen në drejtësi, derisa përmendën kategoritë që janë të lira nga pagesa e taksës. Në këtë drejtim, mes tjerash, nga ta u përmendën raste kur avokatë të ndryshëm kanë parashtruar 5-6 padi për rastin e njëjtë, vetëm për faktin se taksa gjyqësore ka qenë e ulët. Gjithashtu, u tha se qytetarët të cilët e dinë që iu takon një e drejtë, nuk e lënë pa iniciuar procedurën për shkak të taksës gjyqësore. Po ashtu, u tha edhe se në rastet kur pala e arsyeton se nuk mund ta paguaj taksën, atëherë gjykata mund të marr vendim dhe ta lirojë nga taksa.

Në anën tjetër, përfaqësues të profesionit të avokatisë patën mendime tjera në lidhje me këto që u përmendën më lart. Ata u shprehën se rritja e taksës gjyqësore ka ndikuar drejtpërdrejt në cenimin e të drejtave të qytetarëve për qasje në drejtësi. U përmend se disa kategori kanë qenë të lira nga taksa gjyqësore

¹⁷ Intervistë me kryetarin e Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepin (Shih linkun: <https://youtu.be/PJQk4dqgy30?si=KyeyRDkRGEdHTMSq>) & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>); Intervistë me kryetarin e Gjykatës së Apelit, Valon Totaj, (Shih linkun:

¹⁸ “Totaj për ngritjen e taksave gjyqësore: Gjyqësori e ka konston e vet të veprimt”. Betimi për Drejtësi. 10 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/totaj-per-ngritjen-e-taksave-gjyqësore-gjyqësori-e-ka-konston-e-vet-te-veprimt/>. & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Prokurorinë e Apelit". Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-prokurorinë-e-apelit/>

¹⁹ “Arsyetimi i vendimeve, Kryetari Supremes thotë se e kanë trajtuar në vazhdimësi këtë çështje, flet edhe për rritjen e taksave gjyqësore”. Betimi për Drejtësi. 7 mars 2026. Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-vendimeve-kryetari-supremes-thote-se-e-kanë-trajtuar-ne-vazhdimësi-këtë-çështje-flet-edhe-per-rritjen-e-taksave-gjyqësore/>. & IKD. "Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Supreme". (Shih linkun: <https://kli-ks.org/drejtuesit-e-ikd-se-avokojne-per-zbatimin-e-rekomandimeve-ne-gjykatën-supreme/>).

edhe më herët, derisa u theksuan raste të palëve se kur iu kumtohet çmimi i taksës gjyqësore, ata vënë në mëdyshje se a ja vlen të iniciohet procedura për një kontest të vogël. Gjithashtu, u theksua edhe se palët janë laike në këtë fushë dhe nuk mund të dinë pritshmëritë e rastit.

Gjithashtu, rritja e taksës gjyqësore u pa si shqetësuese edhe nga shoqëria civile. Mes tjerash, u tha se do ishte e kuptueshme nëse kjo rritje do ndikonte në përmirësimin e kushteve të objekteve të gjykatave, apo në shërbimin e gjyqësorit ndaj qytetarëve.

12. Përfundime

1. Gjetjet e IKD tregojnë se përderisa disa raste civile zgjidhen brenda vitit kur janë iniciuar, ekzistojnë edhe raste që marrin epilog vetëm pas rreth 12 viteve. Një situatë e tillë ngrit dyshime për trajtim të pabarabartë të rasteve.
2. Ngarkesa e përgjithshme e gjyqësorit me lëndë civile mbetet e lartë, megjithëse gjatë vitit 2025 gjykatat kanë arritur të zgjidhin më shumë lëndë se sa kanë pranuar, duke ulur numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura.
3. Gjykatat themelore kanë performuar pozitivisht, duke zgjidhur më shumë lëndë se sa kanë pranuar, ndërsa një performancë e tillë nuk është evidentuar në Gjykatën e Apelit, tek e cila është rritur numri i lëndëve të pazgjidhura.
4. Ekzistojnë dallime të konsiderueshme në efikasitetin e gjyqtarëve ndërmjet gjykatave. Mesatarja e lëndëve të zgjidhura për gjyqtar ndryshon ndjeshëm nga një gjykatë në tjetrën.
5. Shtyrja e seancave gjyqësore mbetet problematikë. Nga seancat e monitoruara, 22% janë shtyrë. Kjo paraqet regres krahasuar me vitin 2022.
6. Mbajtja e seancave gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve vazhdon të jetë praktikë e evidentuar, edhe në raste kur ka salla të lira gjykimi, gjë që krijon vështirësi në administrimin e seancave dhe kufizon qasjen e publikut.
7. Kohëzgjatja e trajtimit të rasteve civile mbetet e lartë. Mesatarja e trajtimit në gjykatat themelore është rreth 875 ditë, ndërsa së bashku me procedurën në Gjykatën e Apelit arrin në rreth 1451 ditë.
8. Rastet pronësore zvarriten dukshëm më shumë se kategoritë e tjera të rasteve civile. Mesatarja e trajtimit të tyre është më shumë se dyfish më e lartë krahasuar me rastet e pagave jubilarë.
9. Procedura e ndërmjetësimit vazhdon të përdoret në mënyrë shumë të kufizuar. Vetëm 3.76% e rasteve janë zgjidhur përmes ndërmjetësimit.

10. Gjykatat nuk po zbatojnë në praktikë obligimin për informimin e palëve për ndërmjetësimin, pasi në procesverbalet e analizuara nuk evidentohet asnjë rast i njoffimit të palëve për këtë mundësi.
11. Ekziston mosbarazi në shpërndarjen e gjyqtarëve në raport me ngarkesën me lëndë, pasi në disa gjykata gjyqtarët janë të ngarkuar dukshëm më shumë se në gjykatat e tjera.
12. Rritja e taksave gjyqësore rrezikon të ndikojë në qasjen e qytetarëve në drejtësi, pasi tarifat janë rritur ndjeshëm në pothuajse të gjitha kategoritë e padive civile.

13. Rekomandime

1. KGJK duhet të sigurojë trajtim të barabartë të rasteve civile, duke garantuar që rastet të trajtohen sipas kohës së pranimit, përveç rasteve kur prioriteti përcaktohet me ligj.
2. Gjykatat duhet të ndërmarrin masa për uljen e kohëzgjatjes së trajtimit të rasteve civile, veçanërisht në gjykatat me kohëzgjatje më të lartë.
3. Gjykata e Apelit duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e efikasitetit në trajtimin e rasteve, me qëllim të uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura.
4. KGJK duhet të analizojë dallimet në efikasitetin e gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, me qëllim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në këto dallime.
5. Gjykatat duhet të ndërmarrin masa për zvogëlimin e shtyrjes së seancave gjyqësore, duke përmirësuar planifikimin dhe administrimin e seancave.
6. Seancat gjyqësore duhet të mbahen në sallat e gjykimeve dhe jo në zyrat e gjyqtarëve, përveç rasteve kur kjo është e domosdoshme për shkak të kushteve infrastrukturore.
7. KGJK duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e trajtimit të rasteve pronësore, me qëllim të uljes së zvarritjes së tyre.
8. Gjyqtarët duhet të zbatojnë obligimin për informimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së kontestit përmes ndërmjetësimit, në përputhje me rregulloren e KGJK për ndërmjetësim.
9. KGJK duhet të promovojë përdorimin më të gjerë të ndërmjetësimit, si mekanizëm për uljen e ngarkesës së gjykatave.
10. KGJK duhet të shqyrtojë mundësinë e rishpërndarjes së gjyqtarëve përmes institutit të transferimit, në mënyrë që të balancohet ngarkesa me lëndë ndërmjet gjykatave.
11. KGJK duhet të rishqyrtojë nivelin e taksave gjyqësore, në mënyrë që ato të jenë proporcionale dhe të mos krijojnë barriera për qasjen e qytetarëve në drejtësi.

